

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT, MBLEDHJES DHE TRANSPORTIMIT TË MBETURINAVE URBANE NË BASHKINË E HIMARES**

Sipas reformes territoriale, Bashkia e Re e Himares ka ne perberjen e saj tre njesi administrative, ish bashkia e Himares dhe dy ish komunat Lukove dhe Hore-Vranisht. Territori i ri ze nje siperfaqe prej 572 km<sup>2</sup>, ndersa popullsia e kesaj bashkie eshte 27 304 banore, sipas Gjendjes Civile ne fund te vitit 2016. Por ne kete studim do te perfshijme vetem qytetin e Himares dhe Njesine Administrative Lukove, pasi ne ish komunen Hore-Vranisht aktualisht nuk mund te ofrohet sherbimi i pastrimit per shkak se nuk ka rruge moderne qe lidh kete njesi me qytetin e Himares, por nje rruge historike qe nuk eshte e perdorshme. Bashkia Himare dhe Njesia Administrative Lukove se bashku kane nje popullsi prej 23 378 banore dhe 6 950 familje, sipas te dhenave te Gjendjes Civile ne fund te vitit 2016.

### **1. Fshirja e rrugëve me fshese dore.**

Per kryerjen e ketij zeri te punimeve te sherbimit te pastrimit, do te marrim parasysh rruget qe jane te asfaltuara ne qytetin e Himares dhe njesine Lukove . Ne kete ze do te perfshijme edhe ato rruge qe jane me asfalt te demtuar ose me cakull, pavaresisht se nuk kane nje siperfaqe te sheshte per t'u fshire me fshese dore, por qe nuk mund t'i leme per shkak se ne e kemi ofruar kete sherbim edhe me pare dhe qytetaret nuk do e pranonin qe ato te mos fshihen cdo dite. Sipas te dhenave dhe matjeve qe jane bere nga bashkia, nga Drejtoria e Urbanistikës, rruget ku do ofrohet fshirja me fshese dore jane dhene ne tabelen e meposhtme.

### **2. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane me konteniere e mjet teknologjik deri ne vend depozitimin e mbeturinave (Stacioni i Transferimit).**

Bashkia Himare e ofron sherbimin e grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane me konteniere metalike dhe mjet teknologjik ne te gjithë territorin e saj ne qytetin Himare dhe ish komunen Lukove. Kete standard ne e kemi realizuar prej kohesh, por qe nga viti 2003 ne vazhdojme ta ofrojme kete sherbim me konteniere e mjet teknologjik dhe qytetaret tane jane te kenaqur. Sherbimin e grumbullimit e transportimit te mbeturinave urbane ne e ofrojme ne te gjithë territorin e bashkise (Himare dhe Lukove), pra e mbulojme 100% zonen e sherbimit te te dy ketyre njesive administrative. Ne te gjithë qytetin ne kemi rreth 390 konteniere metalike/plastike, bile edhe ne zonat periferike me infrastrukture rrugore jo shume te mire.

Ky sherbim nuk ofrohet ne njesine administrative Hore-Vranisht per shkak te karakteristikave teknike te infrastruktures rrugore dhe aksesit fizik te mjeteve teknologjike, (per kete njesi do te bejme llogaritjet ne nje faze te mevonshme). Kontenieret jane shperndare ne te gjithë zonen e sherbimit, sipas lagjeve, blloqeve te banimit dhe plazheve , sipas tabelës se meposhtme.

Ne te dy njesite administrative, ku do te ofrojme sherbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane, ne do kemi parasysh sasite e regjistruara per cdo dite, jave dhe muaj te mbeturinave urbane qe vene ne landfillin e Bajkaj.

Por mund edhe te bejme llogaritjet indirekte sa do te jete sasia e mbeturinave qe do te gjenerohen cdo dite, duke e perputhur me te dhenat nga landfilli per sasine e mbeturinave urbane dhe numrin e konteniereve qe duhen per grumbullimin e tyre. Per numrin e popullsise se cdo njesie administrative ne do t'i referohemi te dhenave te Gjendjes Civile ne

fund te vitit 2016, duke marre ne konsiderate edhe numrin e popullsise qe jeton aktualisht. Kjo shifer do te percaktohet nga eksperienca jone si dhe te dhenat te tjera qe kemi (psh. nr. i votueseve qe kane marre pjese ne dy votimet e fundit, ne vitin 2015 dhe 2017). Pra, sic e theksuam numri i popullsise ne qytetin e Himares dhe Lukoves eshte 23 378 banore, sipas te dhenave te Gjendjes Civile ne fund te vitit 2016 (ketu nuk eshte perfshire popullsia e ish komunes Hore – Vranisht), ndersa numri i banoreve qe jeton aktualisht eshte rreth 13 456 banore. Sipas te dhena qe kemi nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore ne fund te vitit 2016 kane ushtruar veprimtarine e tyre ne qytetin e Himares 468 biznese, nga keto 417 biznese te vogla dhe 51 biznese te medha, ndersa numri i institucioneve eshte 10.

Per njesine administrative Lukove kane ushtruar veprimtarine e tyre 141 biznese gjithsej, nga keto 124 biznese te vogla dhe 17 biznese te medha, ndersa numri i institucioneve eshte 1.

Gjate stines se veres (qershor – shtator) ka shume biznese qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne bashkine e Himares per nje sherbim me te mire ndaj turisteve vendas dhe te hauj, te cilat ne i quajme biznese sezonale. Ne Himare jane rreth 204 dhe ne Lukove rreth 64, gjithsej 268.

Tabela me te dhenat per bashkine e Himares.

Nr.	Emertimi	Himare	Lukove	Hore-Vranisht	Gjithsej
1	Biznese te vogla	213	60	60	333
2	Biznese te medha	51	17	-	68
3	Biznese Sezonale	204	64	-	268
4	Institucione	10	1	-	11
5	Popullsia	13 486	9 892	3 926	27 304

Kurse numri i konteniereve, duke marre ne konsiderate sezonin e plazhit dhe rritjen e sasise se mbeturinave per stinen e veres (qershor-shtator) do te jete 137 - 152 cope konteniere me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup>. Ne total numri i tyre do te jete 172 - 190 cope konteniere, ose numri maksimal i tyre sipas llogaritjeve del 190 cope.

Ne fakt numri i konteniereve me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup> eshte me i madh dhe arrin ne 390 cope konteniere, kjo per arsye se fshatrat jane te shperndare ne distanca te medha, shume familje kane ndertuar banesat e tyre larg njera tjetres, plazhet e tyre jane te shumta ne numer dhe per rrjedhoje nevoja per konteniere eshte me e madhe, pavaresisht se nuk shfrytëzohet i gjithe kapaciteti i tyre mbajtes per gjate gjithe vitit. Situata e shperndarjes se konteniereve eshte si me poshte:

Himare (+ fshatrat) - g+t, te mbeturinave urbane - 270 konteniere  
 Lukove (+ fshatrat) - g+t, te mbeturinave urbane - 120 konteniere  
 Gjithsej - 390 konteniere

Keto te dhena do te na duhen me poshte kur te llogaritim koston e sherbimit te grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane me mjet teknologjik dhe konteniere metalike/plastike per periudhen normale te vitit dhe per periudhen 4 mujore te plazhit ne stinen e veres (qershor-shtator).

Nga llogaritjet del se duhen maksimalisht 190 konteniere metalike/palstike, por per arsyet qe kemi shpjeguar pak me larte numri i tyre eshte me i madh. Duke qene se ne njesine Himare dhe Lukove (apo ne plazhet e tyre) mjetet teknologjike do te shkojne 6 here ne jave, per periudhen normale gjate vitit dhe 7 here ne jave per stinen e plazhit per 4 muaj ne vit (122 dite pune gjithsej) del se duhen 390 konteniere gjithsej. Pavaresisht se nje pjese e

konteniereve , nuk do te shfrytezohen plotesisht gjate gjithë vitit, ne analizen e koston per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane ne do te llogaritim cmimin njesi per konteniere/dite, ne kete rast eshte  $270 + 120 = 390$  konteniere ne dite.

Ditet e javes	Hene	Marte	Merkure	Enjte	Premte	Shtune	Diel	Mesatarja
Destinacioni i mjeteve teknologjike (5t)	Himare Lukove	Himare Lukove	Himare Lukove	Himare Lukove	Himare Lukove	Himare Lukove		
Distanca nga Himara deri Vumblo, (nje kah)	7 km	7 km	7 km	7 km	7 km	7 km		7 km /dite
Distanca per grumbullim per kamionin (Himare+Lukove)	(50+86) km	136 km	136 km	136 km	136 km	136 km		136 km/dite
Sasia e mbetjeve T/dite	3,4T	3,4T	3,4T	3,4T	3,4T	3,4T		3,4 T/dite

Per rastin e levizjes se mjeteve teknologjike nga Himara ne Palase, Dhermi, Vuno, Ilias e kthim perseri ne Himare eshte llogaritur distanca prej 20 km (plus levizje te brendshme ne keto fshatra e plazhet e tyre) prej 5 km, pra gjithsej 25 km nje sens dhe komplet per rrugen vajtje - ardhje distanca eshte 50 km.

Per rastin e levizjes se mjeteve teknologjike nga Himara ne Palermo, Qeparo, Lukove, Shen Vasil, Nivice e kthim perseri ne Himare eshte llogaritur distanca prej 38 km (plus levizje te brendshme ne keto fshatra e plazhet e tyre) prej 5 km, pra gjithsej 43 km nje sens dhe komplet per rrugen vajtje - ardhje distanca eshte 86 km.

Duke patur parasysh te dhenat e mesiperme ne do te llogaritim edhe sasine e karburantit qe duhet per mjetin teknologjik (5T), i cili do te perdoret nga firma private e sherbimit te pastrimit cdo dite per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave te ngurta urbane nga njesite Himare dhe Lukove. Per te nxjerre sasine e karburantit do te marrim ne konsiderate qe kostoja e plote perbehet nga kostoja e grumbullimit te mbeturinave dhe kostoja e transportit te tyre deri ne vend depozitimit e tyre ne Vumblo.

Pershkrimi i punes:

- Kontenieret e mbeturinave jane vendosur ne te gjithë territorin e bashkise, ne vende te caktuara, sipas kushteve higjens - sanitare, per grumbullimin e mbeturinave urbane.
- Punetoret e transportit kane per detyre te heqin te gjithë mbeturinat familjare nga pikat e grumbullimit, te bejne fshirjen me fshese dhe dezinfektimin me gelqere pluhur dhe clor te vend grumbullimit me nje rreze prej 3ml.
- Mjetet teknologjike kryejne transportimin e mbeturinave nga qyteti deri ne Stacionin e Transferimit (vend depozitimi i mbeturinave), distanca rreth 7 km nga qendra e qytetit.
- Cdo mjet teknologjik ka zonen e tij te sherbimit, ben mesatarisht 136 km/dite sipas grafikut te levizjes dhe ne zonen e sherbimit Himare e Lukove jane rreth 390 konteniere metalike/plastike.

### 3. Larja e konteniereve metalike per grumbullimin e mbeturinave urbane.

Per te patur nje standard te mire dhe te pranueshem ne sherbimin e pastrimit mendojme qe te futim edhe sherbimin e larjes dhe dezinfektimit te konteniereve te mbeturinave urbane me mjet teknologjik. Ky sherbim i ri eshte i nevojshem, jo vetem per te patur konteniere te paster, qe nuk vijne ere te rende e te keqe nga prania e mbeturinave organike qe ngjiten ne fund te kontenierit, por edhe per te mbrojtur kontenieret nga korodimi i shpejte dhe ulja e

jetegjatesise se tyre. Ky sherbim do te ofrohet 52 dite ne vit. Sasia e konteniereve ne bashkine e Himares eshte 390 .

Larja e dezinfektimi i 390 cope konteniereve metalike/plastike ne Himare e Lukove nje here ne muaj. Do te lahen 30 cope kontenire metalike ne dite, pra 13 dite pune ne muaj (390:30). Gjithsej ky sherbim do te kryhet 52 dite ne vit (13 dite pune muaj x 4 muaj).

Pershkrimi i punes:

a. Larja e dezinfektimi i 390 cope konteniereve do te behet ne menyre periodike, per 4 muaj ne vit te gjithë kontenieret do te lahen dhe dezinfektohen, me uje me presion me automjet teknologjik per larjen dhe dezinfektimin e tyre, ose ne lavazhon e firmes sipermarrese.

Qellimi i punes: Kontenieret metalike duhet te jene te paster dhe te dezinfektuar ne menyre qe te plotesohen kushtet higjeno sanitare ne qytet, te shmanget era e rende e mbeturinave dhe ruajtja e jetegjatesise se tyre per shkak te korodimit te fundit te kontenierit.

#### **4. Lagia e rrugeve e shesheve ne te gjithë qytetin.**

Ky sherbim ofrohet vetem ne qytetin e Himares, por mund te perfshihen edhe rruge te tjera si ne Lukove apo ne ndonje fshat tjetër turistik, ku eshte e nevojshme te perfshihet ky sherbim sidomos ne kohen e plazhit. Keshtu per sherbimin e lagies se rrugeve ne do te perfshijme rruget e asfaltuara ne gjendje te mire, si ne qender dhe ne periferi te qytetit Himare. Ky eshte nje sherbim shume i kerkuar edhe nga qytetaret tane dhe per kete arsye ne do te rritim siperfaqen e rrugeve per lagie, vecanersht ne stinen e veres per pese muaj (maj-shtator).

Sipas te dhenave qe kemi dhe verifikimeve te bera ne terren ne kete sherbim do te futen rruget si ne tabelen e meposhtme:

Per Bashkine Himare do te llogaritim nje siperfaqe prej rreth 40 000 m<sup>2</sup>, nga inventari i rrugeve qe fshihen cdo dite ne total prej 133 600 m<sup>2</sup>, ne te gjithë territorin e bashkise.

Per lagien e rrugeve dhe shesheve te qytetit Himare do perdoret nje mjet teknologjik me kapacitet 10 m<sup>3</sup>, te cilin duhet ta disponoje sipermarresi i sherbimit te pastrimit. Sprucatorët e mjetit teknologjik duhet te jene ne gjendje te mire dhe me nje kend drejt tokes, te pershtatshem per hedhjen e ujit me presion dhe pa shkaktuar humbje te ujit. Si normative per lagien e rrugeve do te merret 0,5 litra uje per 1 m<sup>2</sup> rruge. Kjo normative siguron nje lagie te mire te rrugeve e shesheve sidomos ne stinen e veres, ku duhet nje sasi me e madhe e ujit per te lagur rruget. Per siperfaqen totale te rrugeve e shesheve prej 40 000 m<sup>2</sup> duhen rreth 20 m<sup>3</sup> uje ne dite ne mengjes dhe 20 m<sup>3</sup> mbasdite, ose 4 rruge cdo dite per nje autobot me kapacitet 10 m<sup>3</sup>. Lagia e rrugeve dhe shesheve kryesore te qytetit do te behet per 5 muaj (maj, qershor, korrik, gusht, shtator): -1 Maj - 30 Shtator - me 2 lagije cdo dite (mengjes dhe mbasdite) Per 5 muajt, maj - shtator do te jene 153 dite pune gjithsej, me dy lagije ne dite, mengjes dhe mbasdite, pra cdo dite te javes.

Qellimi i punes: Lagia e rrugeve dhe shesheve kryesore, pas fshirjes me fshese, per te freskuar mjedisin si dhe per te eliminuar pluhurin. Lagia e segmenteve te rrugeve apo shesheve pas permbytjeve ne situata jo te zakonshme.

#### **5. Heqja e mbetjeve solide voluminoze nga pikat e grumbullimit dhe ambientet e tjera publike ne te gjithë qytetin, me skuadren e pastrimit.**

Gjate veprimtarise se tyre te perdritshme familjet, bizneset dhe institucionet prodhojne mbeturina urbane, te cilat grumbullohen e transportohen nga firma sipermarrese e pastrimit deri ne vend depozitimin e tyre ne Vumblo?. Por krahas mbeturinave urbane familjet nxjerrin

edhe mbetje solide (dhera, materiale inerte, ndertimore, mbetje voluminoze etj.) te cilat i hedhin ne pikat e grumbullimit ose ambjente te tjera publike.

Bashkia Himare ka marre masa per te parandaluar kete fenomen dhe ia ka bere te qarte qytetareve se mbetjet solide, duhet te mos i hedhin te pikat e grumbullimit te mbeturinave urbane dhe t'i largojne me shpenzimet e tyre, per ne vend depozitimin e tyre. Ka shume raste qe qytetare te papergjegjshem i hedhin mbetjet solide prane pikave te grumbullimit, fshehurazi e sidomos naten. Kur i gjejme autoret policia bashkiake i detyron t'i largojne vete qytetaret, bile edhe duke i gjobitur.

Por ne shume raste ne nuk i gjejme dot fajtoret dhe detyrohemi t'i largojme me automjetet e firmes sipermarrese, duke futur ne analizat e kostos edhe kete sherbim. Ky sherbim do te ofrohet 6 dite ne jave ne Himare dhe Lukove, pra me dy automjete vetshkarkuese.

Heqja e mbetjeve solide dhe voluminoze nga pikat e grumbullimit dhe ambjentet e tjera publike ne te gjitha territorin e bashkise, me skuadren e pastrimit.

Pershkrimi i punes:

a. Pastrimi i mjedisit nga mbetjet inerte dhe voluminoze, ndermjet pallateve dhe qendrave te banuara dhe transportimi i tyre per ne vend depozitimin e mbetjeve inerte .....

b. Pastrimi dhe transportimi i dherave e mbetjeve te tjera te ngurta prane pikave te grumbullimit, ne te gjitha zonen e sherbimit ne bashki.

Qellimi i punes: Te kemi mjedise sa me te pastra ne te gjitha qytetin pa mbetje solide e voluminoze prane pikave te grumbullimit te mbeturinave, ose ne ambjente te tjera publike.

## **6. Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane ne plazhe (Himare e Lukove)**

Gjate stines se veres qershor – shtator ne Himare e Lukove si dhe ne zona te tjera te bashkise Himare vijne shume turistte vendas dhe te huaj dhe sigurisht ne keto 4 muaj sasia e mbeturinave urbane rritet shume. Kjo rutine e pervitshme ka detyruar bashkine Himare qe te marre masa plotesuese ne heqjen e mbeturinave urbane nga plazhet e saj, per te mbajtur sa me te paster te gjitha zonat e plazhit ne menyre qe te gjitha turistet qe frekuentojne keto plazhe te jene te kenaqur e shume te kenaqur.

Per kete arsye bashkia ka punesuar 8 punetore, 4 ne Himare dhe 4 ne Lukove, te cilet bejne grumbullimin e transportimin e mbeturinave urbane nga zonat e plazhit ne pikat me te aferta te konteniereve. Keta punetore punojne vetem 4 muaj ne vit ose 122 dite/vit, duke bere grumbullimin e mbeturinave urbane ne kontenieret metalike/plastike te vendosur ne zonat e plazheve, me nje siperfaqe prej 313 824 m<sup>2</sup> gjithsej.

Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane ne plazhe e mirembajtja e tyre.

Pershkrimi i punes: Heqja e mbeturinave urbane nga zona e plazheve dhe transportimi i tyre te pikat e grumbullimit, te kontenieret me te afert.

Qellimi i punes: Te kemi mjedise sa me te pastra ne te gjitha zonat e plazheve publike.

## **7. Ndarja e mbeturinave sipas perberjes mercologjike, ne dy rryma kryesore me qellim riperdorimin dhe riciklimin e mbeturinave urbane. Kompostimi i mbeturinave organike ne vend depozitimin e tyre ne Vishaj (Vumblo) , rreth 7 km nga qyteti Himare.**

Per here te pare mendojme te bejme ndarjen e mbeturinave urbane sipas perberjes mercologjike, me qellimin kryesor riperdorimin, riciklimin e mbeturinave urbane, si dhe kompostimin e mbeturinave urbane organike ne bashkine Himare.

Vend depozitimi i mbeturinave urbane ne Vumblo, rreth 7 km larg nga qyteti i Himares, pergatitur si Stacion Transferimi nga Banka Boterore.

Ne rastin e pare kemi nje vend te pershtatshem ne qafen e Vishaj qe mund te perdoret si vend kompostimi i mbeturinave urbane organike. Ky vend ka nje siperfaqe prej 2000-2500 m<sup>2</sup> qe mund te sherbeje per te ndertuar kavaletat per kompostimin e mbeturinave urbane organike, duke e rehabilituar me vone kete zone ne nje siperfaqe te gjelbert.

Kurse ne rastin e dyte ne Vumblo kemi nje vend depozitim te gatshem dhe shume te mire, ku ne pjesen e pare eshte ndertuar nje tetoje per ndarjen e mbeturinave sipas perberjes mercologjike. Ky vend eshte shume i mire per te realizuar ndarjen e mbeturinave urbane ne burim, me synim riperdorimin dhe riciklimin e tyre, si dhe ne pjesen jugore te tij eshte nje siperfaqe toke prej rreth 2 000 m<sup>2</sup>, qe eshte nje vend shume i pershtatshem per te bere kompostimin e mbeturinave urbane organike, per te prodhuar pleh organik.

Per te bere nje gje te tille bashkise do t'i duhet te investoje nje sasi kontenieresh te rinj, te cilet do te sherbejne per grumbullimin e mbeturinave te lengshme organike dhe do te shperndahen ne qytet, si dhe 120 ne lokale, restorante ku do te shfrytezohen mbeturinat organike qe prodhojne keto lokale cdo dite. Pjesa kryesore e ketyre restoranteve eshte ne Dhermi, Himare, Borsh dhe Lukove. Nga ky numer restorantesh 80 prej tyre jane shume te frekuentuar dhe per kete shkak ata prodhojne sasine me te madhe te mbeturinave organike per kompostim gjate vitit dhe ne stinen e veres. Po keshtu prodhojne (gjenerojne) edhe sasi te tjera te mbeturinave urbane te thata per riciklim. Per te realizuar ndarjen e mbeturinave urbane vetem per keta restorante do te duhen:

Kazane plastike per mbeturina te lengshme oragnike (100 dhe 200) litra - 80 cope

Kazane plastike per mbeturina te that ate riciklueshme (100 dhe 200) litra - 80 cope

Shuma - 160 cope

Ndersa ne qytetin e Himares jane rreth 132 konteniere 1,1 m<sup>3</sup>, te cilet perdoren per grumbullimin e mbeturinave ne qytetin e Himares dhe nga keta rreth 120 konteniere 1,1 m<sup>3</sup> do te dublohen ne te gjitha pikat kryesore ne qytet, per te grumbulluar mbeturina te lengshme oragnike per kompostim. Ata do te jene me ngjyre bojeqielli ose "blu" ku ne faqen e tyre do te shkruhen fjalet: mbetje organike.

Kurse per mbeturinat urbane te thata per riperdorim dhe riciklim do te perdoren kontenieret ekzistues, por duke i lyer me ngjyre te "gjelber" ku ne faqen ballore te tyre do te shkruhen fjalet: leter/karton; bidona/qese plastike; metalike/qelq.

Per te realizuar objektivat e Strategjise Kombetare te Mbetjeve, ne menyre qe te kemi nje devijim te qendrueshem te mbetjeve nga landfillet si dhe te kontribuohet drejt plotesimit te objektivateve per riciklimin dhe kompostimin, Plani Kombetar i Menaxhimit te Mbetjeve sugjeron zbatimin sa me te shpejte, te sistemit te grumbullimit te pakten me dy konteniere te veçante me ngjyra si me poshte: mbetje organike te kompostueshme do te grumbullohet ne konteniere me ngjyre "blu" mbetje te thata te riciklueshme do te grumbullohen ne konteniere me ngjyre "te gjelber"

Megjithate duke u bazuar tek buxheti aktual qe ka bashkia Himare ne dispozicion per sherbimin e pastrimit dhe te menaxhimit te mbetjeve, mund te themi qe zbatimimi i nje sistemi te tille do vazhdoje te ngelet nje sfide edhe per periudhen afatshkurter, jo vetem per bashkine Himare, por edhe per shume bashki te tjera te vendit tone. Ne periudhen afatgjate 2017 - 2025 do te synohet: te zbatohet mbledhja e diferencuar e mbeturinave e bazuar tek sistemi me dy

konteniere, ngritja e qendrave te mbledhjes se diferencuar te rrymave te ndryshme te mbeturinave

Ndertimi i stacionit te transferimit ne nivel rajonal, i cili do te optimizoje koston e transportit dhe do te mundesoje nje perdorim me te gjere te "landfillit" te ardhshem rajonal. Per kete bashkia do te kerkoje qe edhe firma sipermarrese e sherbimit te pastrimit te kontribuojte, per blerjen e nje fadrome (skrep) qe duhet per proceset e punes, per ndarjen e mbeturinave per riciklim dhe kompostim. Duke patur parasysh sasine vjetore te prodhimit te mbeturinave urbane prej 2 745 ton, e cila do te rritet ne vitet ne vijim ndoshta ne 3 000 ton/vit, mendojme se do te duhet nje transportier dhe dy presa qe do te nevojiten per presimin e letres, kartonit, qeseve plastike, bidonave plastike. Kjo mund te realizohet ne Stacionin e Transferimit ne Vumblo ku eshte ndertuar tetoja me siperfaqe rreth 2 500 m<sup>2</sup> ku do te behet ndarja e mbeturinave, te pakten per leter, karton, qese plastike, bidona plastike, qelq, metalike etj., si dhe kompostimi i mbeturinave organike po ketu, pjesa e tokes ne jug te tij.

Eshte gje shume e mire qe ne Vumblo eshte eshte lidhur energjia elektrike aq e nevojshme per transportieret, makinat grirese te plastikës dhe presat (elektromotoret e tyre). Po te kemi parasysh koston e investimeve kapitale mund te themi se nje pjese do te perballohet nga bashkia Himare, nje pjese nga sipermarresi i sherbimit te pastrimit.

Ndarja e mbeturinave sipas perberjes mercologjike, ne dy rryma kryesore me qellim riperdorimin dhe riciklimin e mbeturinave urbane. Kompostimi i mbeturinave organike ne vend depozitimin e tyre ne Vishaj (Vumblo), rreth 7 km nga qyteti Himare.

Pershkrimi i punes:

Punetoret do te bejne ndarjen dhe paketimin e mbeturinave te thata te riciklueshme te ndara si leter, karton, bidona plastike, qese plastike, metalike, qelq etj. brenda tetojes, duke shfrytezuar linjen e transportierit dhe presave, gjate gjithë vitit 312 dite pune.

Me ndihmen e fadromes me thike do te behet sistemimi e transportimi i mbeturinave te lengshme organike qe vijne ne kete vend depozitim, si dhe ato qe do te ngelen nga ndarja e mbeturinave, duke i cuar ne kavaleta e duke i mbuluar mbeturinat me dhe. Gjithsej 312 dite pune ne vit.

Kurse mbeturinat e rrezikshme, ato qe jane shume te ndotura, mbeturina tekstile, rroba, kepuce etj. do te ndahen me vete, duke i hedhur ne disa konteniere te vecante dhe kur te mbushet sasia e nevojshme per transport do te cohen me mjet teknologjik ne landfillin e Bajkaj.

Qellimi i punes: Te realizojme ndarjen e mbeturinave te thata ne dy rryma leter/ karton dhe bidona/qese plastike, qelq/metalike etj. ne menyre qe t'i hapet rruge riperdorimit dhe riciklimit te tyre si dhe zvogelimit te sasise se mbeturinave qe do te cohen ne landfillin e Bajkaj. Te realizojme kompostimin e mbeturinave urbane te lengshme organike per prodhimin e plehut organik, i cili do te perdoret per nevoja te gjelberimit ne bashkine Himare. Te kemi nje vend depozitimi te sistemuar dhe pa mbeturina te perhapura ne mjedisin perreth.

## **8. Edukimi publik ambjental i qytetareve:**

Planifikimi i edukimit publik ambjental te qytetareve, eshte i rendesishme krahas, aspekteve financiare dhe legjislativë dhe eshte nje nga kater shtyllat ku bazohet Politika dhe Strategjia Kombetare e Manaxhimit te Mbetjeve.

Nisur nga situata aktuale ambjentale e regjimit te mbetjeve dhe perhapja e mbeturinave ne mjediset e ndryshme ne territorin e Bashkise Himare, eshte teper e nevojshme hartimi dhe implementimi i nje plani qe lidhet me edukimin publik ambjental te qytetareve dhe jo vetem.

Ne kete kuader kategorite e publikut qe duhet per t'u planifikuar ne seancat e degjesave publike dhe trainimit te tyre jane si me poshte: Te rinjte e shkollave 9 vjecare dhe te mesme, Familjaret e zonave urbane te Himares, Dhermiut dhe Lukoves, Familjaret e zonave rurale, Perfaqesuesit dhe punonjesit e hoteleve restoranteve dhe bizneseve private, Nepunesve dhe specialisteve te bashkise dhe kryepaqte, Shoqeria civile

Bazuar ne kategorite e mesiperme te publikut do te ndiqen skema degjesash, trainimesh dhe aksione publike (vullnetare) ne kuader te mbrojtjes se mjedisit dhe kryesisht te mire administrimit te mbeturinave urbane. Keshtu me nxenesit e shkollave do te organizohen degjesa dhe trajnime te karakterit te pergjithshem te mbrojtjes se mjedisit si dhe me konkretisht me menytrat e trajtimit te mbetjeve, si grumbullimin, ndarjen ne burim sipas perberjes mercologjike te tyre, menytrat e riciklimit dhe ndergjegjesimin e tyre dhe familjareve te tyre. Keto degjesa dhe trajnime do te bashkerendohen edhe me aksione vullnetare te nxenesve per pastrimin e mjedisit urban, plazheve te territorit te Bashkise Himare si dhe te zonave te grumbullimit te mbetjeve urbane. Do te percaktohet qe ne Bashkine Himare te kete nje dite te percaktuar ne muaj per "Aksion Publik Vullnetar" ku si protagoniste te jene nxenesit e shkollave si dhe grupe te ndryshme te interesit. Do te hartohen projekte mbeshtetese per nxenesit e shkollave per perdorimin e mbetjeve te ricikluesme dhe kthimin e tyre ne paisje te ndryshme dhe vepra arti.

Takime dhe trajnime do te organizohen edhe me kategorite e tjera te publikut dhe si aksione specifike do te jete, jo vetem ndergjegjesimi por edhe paisja sidomos e familjareve me qese plastike me synim kryesor ndarjen ne burim te mbetjeve urbane te mundeshme per tu ricikluar. Per familjaret e zonave rurale do te kryhen trainime per menytrat e kompostimit te mbetjeve urbane dhe mbetjeve bujqesore e blegtorale.

Trajnime specifike do te kryhen edhe me punonjesit e hoteleve restoranteve dhe bizneseve private, lidhur me menyren e ndarjes se mbetjeve ne menyre te diferencuar dhe te ndara qe ne burim, duke mbeshtetur dhe me infrastrukturen e nevojshme te kazaneve dhe koshave te ndara per mbetje organike me vete, dhe per mbetjet e thata te riciklueshme plastike, leter e metalike, si dhe te shisheve te qelqta me vete. Do te behen demonstrime per ndarje ne burim.

Trajnime dhe degjesa publike me nepunes, specialiste dhe shoqerine civile do te konsistoje ne menyren e administrimit dhe manaxhimit te mbetjeve urbane, rurale dhe te bizneseve, metodat e ndarjes ne burim, seleksionimit, grumbullimit, transportit dhe perpunimit te metejshem te mbetjeve ne menyre qe te arrihet reduktimi i tyre dhe te ulet sasia e mbetjeve te pa perpunuara me destinacion landfillin e Bajkajt. Do te behen demonstrime per ndarje ne burim te mbeturinave me familjaret ne zonen urbane dhe ngritjen e kavaletave per kompostimin e mbeturinave organike me familjaret ne zonen rurale.

Trajnime dhe aksionet demonstrative te parashikuara per Edukimin publik ambiental te qytetareve do te shoqerohen edhe me spote publicitare te transmetuara ne TV Lokal te qyteteve te Sarandes ose te Vlores, flete palosje, postera dhe banderola dhe reklama te ndryshme te dukshme per nje pjese te madhe te komunitetit te bashkise Himare.

Qellimi eshte te ndergjegjesoje e orientoje qytetaret, si dhe autoritetet vendore drejt masave praktike, veprimeve ne lidhje me mbrojtjen e mjedisit ne pergjithsi, grumbullimin, trajtimin e mbetjeve, sistemet e riciklimit dhe infrastrukturen e nevojshme.